STATE OF NEW YORK | EXECUTIVE CHAMBER

ANDREW M. CUOMO | GOVERNOR

Për Njoftim të Menjëhershëm: 14 mars 2013

GUVERNATORI KUOMO (CUOMO) NJOFTON RIMBURSIMIN FEDERAL PER FSHATIN E MINEOLES (MINEOLA) PER KOSTOT E SUPER STUHISE SENDI (SANDY)

Guvernatori drejton mbi 300,000 dollarë në fonde të miratuara nga FEMA tek Mineola për kostot e pastrimit pas super stuhisë Sendi (Sandy)

Guvernatori Endrju M. Kuomo (Andrew M. Cuomo) njoftoi sot se Shteti i Nju Jorkut (New York State) ka siguruar 311,503 dollarë për Fshatin e Mineolës (Mineola) në Qarkun Naso (Nassau County) për rimbursimin e kostove të pësuara nga fshati pas pasojave të super stuhisë Sendi (Sandy). Fshati i Mineolës (Mineola) përjetoi pemë të dëmtuara dhe të shkatërrura anembanë fshatit. Dëm ndodhi në rrugët e fshatit dhe mbeturinat e drurit ishin vendosur në cepa të rrugëve brenda fshatit nga pronarët e pronave private.

Kostot e pastrimit të Fshatit përfshinë heqjen, transportimin, depozitimin, pakësimin dhe eleminimin e 6,086 jardë kub të mbeturinave të drurit.

“Kudo anembanë komuniteteve të prekura nga super stuhia Sendi (Sandy), një sfidë e përsëritur për çdo komunë ishte nevoja për të hequr shpejt mbeturinat e pemëve që praktikisht kishin rënë në çdo fshat, qytezë dhe qytet në rrugën e stuhisë,” tha Guvernatori Kuomo (Cuomo). “Ashtu si komunitetet anembanë rajoneve të prekura nga stuhia, Fshati i Mineolës (Mineola) u përgjigj shpejt për të hequr mbeturinat e pashembullta të pemëve nga komuniteti i tyre dhe përdorën fondet e fshatit të tyre për të realizuar këtë detyrë të rëndësishme. Në emër të shtetit, jam shumë i gëzuar që jam në gjendje të drejtoj këto fonde përsëri tek fshati dhe t’i ndihmoj ata të vazhdojnë në përpjekjet e tyre të përgjithshme për rimëkëmbje.”

“Kur goditi Sendi (Sandy), Mineola nuk hezitoi. Punonjësit e urgjencave dhe personeli i Fshatit lanë familjet dhe shtëpitë e tyre dhe trajtuan detyrën e vështirë dhe të rrezikshme të rimëkëmbjes. Pavarësisht nëse ishte në pastrimin e rrugëve, heqjen e pemëve ose masa të tjera të panumërta, Fshati mori iniciativën. Nëpërmjet këtij rimbursimi, vlerësojmë përpjekjet e tyre dhe bëjmë pjesën tonë për të siguruar se këto kosto të mbartura nga Fshati nuk përfundojnë në shpinën e taksapaguesve tanë,” tha Senatori Xhek. M. Martins (Jack M. Martins).

Anëtari i asamblesë Eduard Ra (Edward Ra) tha, “Ashtu si të gjitha fshatrat dhe komunat në Long Ajlënd (Long Island), Fshati i Mineolës (Mineola) veproi shpejt pas super stuhisë Sendi (Sandy) për të pastruar mbeturinat dhe rreziqet ndaj sigurisë nga rrugët tona publike. Falënderoj Kryetarin Shtraus (Strauss), Bordin e Fshatit (Village Board) dhe DPW-në për punën e tyre duke ndihmuar që Fshati të rimëkëmbet nga Sendi (Sandy) dhe Guvernatorin për drejtimin e këtij rimbursimi tek Fshati. Shpresoj të vazhdoj të punoj me Guvernatorin Kuomo (Cuomo) për të ndihmuar në mbështetjen e të gjithë banorëve të Nju Jorkut (New Yorkers) që përpiqen pas kësaj stuhie.”

“Këto fonde të Ndihmës Publike janë jashtëzakonisht të rëndësishme për komunitetet që pësuan dëmtim të konsiderueshëm të shkaktuar nga super stuhia Sendi (Sandy), për të ndihmuar që çdo komunitet të rimbushë buxhetet e tyre të zbrazura,” tha Komisioneri i Seksionit të Sigurisë së Atdheut dhe Shërbimeve të Urgjencës të NYS-së (NYS Division of Homeland Security and Emergency Services Commisioner) Xherom M. Hauër (Jerome M. Hauer).

Dhënia e këtyre fondeve federale është pjesë e rimbursimeve në vazhdim dhe në pritje në të ardhmen që shteti do të administrojë dhe paguajë tek komunat e prekura. Komunat janë duke u rimbursuar mbështetur në një shumëllojshmëri projektesh që përfshijnë ndërtimin dhe shkatërrimin, heqjen e mbeturinave ranore dhe bimore, aktivizime të EOC-së, largime, kontrolle dhe riparime dhe rivendosje emergjente të teknologjisë së informacionit dhe programin Strehimi dhe Energjia Thelbësore e Përkohëshme (Sheltering and Temporary Essential Power) (STEP). Shteti do të vazhdojë t’i bëjë këto pagesa të rimbursimeve ndërsa FEMA jep fondet.

###

Lajme të tjera të disponueshme në www.governor.ny.gov
Shtetit të Nju Jorkut | Executive Chamber | press.office@exec.ny.gov | 518.474.8418